

Shkruan: Engjëll I. Berisha

BESIM XHELILI, “VOLUM POETIK ME TRAZIME DASHURIE”

T’i dëftosh botës me dritën e shpirtit tënd, më së shumti refleksioni poetik e ka këtë fuqi. Pikërisht kur ndodhesh në mes fjalës dhe veprës, e që dëshiron t’i bësh një, në mes braktisjes e dashurisë, e që dëshiron t’i arsyetosh, në mes synimeve dhe veprimeve, e që dëshiron t’i kulmosh, besoj se është gjendje sa e jashtëzakonshme e një krijuesi, po aq edhe art i vërtetë, me prurje idesh pozitive. Mu në mes tyre ndodhet edhe fjala poetike e krijuesit Besim Xhelili, shumë voluminoze në strukturime shprehjesh, që nuk e ka për herë të parë këtë paraqitje, por, e vargon rruzaren e tij në rrathët e mendimit që nuk i ndalen e nuk i shuhën lehtë.

Se trangu vlerësohet sipas frutave, poezia e shumë krijuesve nëpër dyer të botës, është pemë me fruta të dobishëm, përderisa në këtë relacion, poeti Xhelili, mbetet fuqi aktive, furor poeticus, me shprehje besimi duke i shtruar gjithnjë taban, siç thoshte Ciceroni, sinqeriteti i fjalëve dhe i marrëveshjes me fjalën e thënë.

Dhe, kur duam t’ia veshim gjitha të këqijat fatit, poeti, në këtë rast, në përmbledhjen e tij “Besa”, sado që e paraqet fatin në rrokullimë, në bredhje të vetvetes, ai e veshë solemn fatin e tij, ia jep dashurinë dhe bëhet forcë për ta mbijetuar çdo situatë. Këtë dhe mëton poezia, të bëhet çelës, nëpërmjet refleksionit të hapet dritë e shpirtit, apo të na mbajë gjallë.

Ndonëse poezia nuk flet me numra, flet me kohën dhe me trazimin e saj, një numër i konsideruar i poetëve, që shkruajnë poezi në gjuhën shqipe, janë frymë e të njëjtës dallgë jete, sikur të kishin vetëm një damarë, duke i lexuar ato, të duket se po lëviz nga njëra libër në tjetrën, pa shikuar fare autorësinë. Këtë kolonë motivuese, e ka bërë fati i përbashkët kolektiv që është kthyer në art të ndikueshëm.

Kështu, duke lexuar Besim Xhelilin në poezitë e tij, lexon koherencën e shkrimit poetik të disa gjeneratave që nuk kanë se si t’i ikin fjalës trazim, dashuri,

mall e shumë morfemave tjera që formojnë kuptime. Dhe, gjithsesi, poeti Xhelili, paraqet vetveten në shumësinë, e në madhësinë e poezisë shqipe.

Qëmoti studimi i letërsisë ka hapur sirtarë të poezisë që shkruhet jashtë Atdheut, e që herë mëton ta trajtojë si poezi e mërgimit, e diasporës, apo jashtë Atdheut. Por, kurrsesi të mbetet në sirtarë të mbyllur, sepse, poezia që vjen nga këta krijues, nuk e ka izoluar shpirtin e tyre, dhe nuk lë vend për izolim. Bile, është më e zgjuar, sepse vetë shpirti i tyre është shpend lëvizës, pa pushuar në asnjë kufi. Ky, quhet trazim, e që tek Besim Xhelili, gati në çdo poezi, paraqitet e shenjzuar, por, pa u bërë hendikep i këtij shqetësimi. Këtë e bëjnë poetët e mëdhenj, duke mos u epur, duke mos iu dorëzuar asnjë fundi, sepse vetë poezia nuk nënkupton fundin e krijuesit.

Përmbledhja poetike, më e fundit e Besim Xhelilit, në përmbajtje, është volum paksa shumë i dendur me shprehje, me shumë reshje mendimesh në një poezi, e që do t'ishte mirë të ketë më shumë dritare, përderisa vetë fjala poezi, ka kuptimin e ndërtimit të ideve, e që i duhet ndërtimi estetik, aq sa i duhet kumbimi. Dritare prej nga mund të kalojë freskia më lehtë gjatë leximit, sepse, kaq e dendur, me shumë shprehje e simbole, të lë përshtypjen se në çdo strofë ka qenë shumë i "armatosur" në njëfarë mënyre shumë i mbushur, dhe ndonjëherë ngufatin ndjenjën gjatë leximit, apo, janë aq energjike, saqë edhe ti kur i lexon, mbushesh me frymë sikur se autori. Kjo është ajo energjia aktive e krijuesve që duan të jenë të sinqertë në mes synimeve e veprimeve.

Çka do që të ndjejë lexuesi gjatë leximit, nuk mund t'i ikë kuptimit dashuri, dashuri në mungesë, syve të errësuar nga mungesa, duarve të thara nga prekja, procesin e natyrës me proceset shpirtërore që thajnë trupin e njeriut, ëndrrat, të cilave poeti u kërkon ndihmë, të paktën në ëndërr ta realizojë dëshirën e tij, dhe të dalë nga ajo agoni, me besimin te Zoti, me besim te e vërteta e thënë, se as nuk rron kot, as nuk dashuron kot, as nuk e bën si mëkat, por krejt i çiltër me atë që ia thotë zemra. Hiçi nuk ekziston thonë sentencat e vjetra, sepse, asgjë nuk zë fill nga asgjëja siç e paraqet teoria nihiliste. Ashtu, sikur te Xhelili, gjini njerëzore, irritabile, më së shpeshti mundohet t'i sforcuojë mendimet, për të na bindur se ka shumë dashuri, ka dhimbje dhe nuk e fshehë dot.